



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 35, datë 27.03.2019

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TESTIMIT TË NJOHURIVE TË
KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR LICENCË/RINOVIM LICENCE
NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI